

E DREJTA PËR INFORMIM



“Roli global i të drejtës për informim për konsolidimin e demokracisë”, Konferenca e 14-të e ICIC.

“Ndërveprimi mes shteteve: Roli global i të drejtës për informim për konsolidimin e demokracisë, gjithëpërfshirjen dhe zhvillimin” ishte tema e edicionit të 14-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioners - ICIC). Ky është aktiviteti kryesor vjetor botëror që mbledh komunitetin e profesionistëve të fushës së aksesit në informacionin me karakter publik, në fokus të të cilit është forcimi i transparencës dhe integritetit të autoriteteve publike. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të autoriteteve anëtare e vëzhguese të organizatës nga të gjitha kontinentet, por edhe nga organizma partnere, bota akademike, shoqëria civile, media, etj.

Përgjatë 2 ditëve të punimeve të Sesionit të Hapur pjesëmarrësit diskutuan për çështje të rëndësishme, si: forcimi i veprimtarisë së institucioneve mbikëqyrëse të të drejtës për informim; aksesit në informacion si një përgjigje ndaj sfidave moderne të demokracisë; rolin e kësaj të drejte në nxitjen e zhvillimit ekonomik-shoqëror; prokurimet publike transparente që

ndikojnë në efektivitetin e kostove për ekonominë; dez-informimi, rreziqet dhe përdorimi i inteligjencës artificiale; si dhe krahasimi i modeleve të ndryshme rregullatore dhe nevoja për përmirësimin e forcimit të standardeve ligjore.

Gjithashtu, të pranishmit morën pjesë edhe në takime të rrjeteve e grupeve rajonale apo në seminare/uorkshope paralele, ku u diskutua mbi ndërveprimin e organizmave publike me sektorin privat në kuadër të transparencës; trajtimin e rasteve në optikën e të drejtës për informim që lidhen me problematikat me bazë gjinore apo për grupet e cenushme.

Pas dy ditëve intensive të sesionit të hapur të konferencës, anëtarët dhe vëzhguesit e ICIC u mblodhën në sesionin e mbyllur ku u njohën me rezultatin e zgjedhjeve të anëtarëve të rinj të komitetit ekzekutiv të ICIC për periudhën 2023 - 2026. Gjithashtu, u miratua një ndryshim i propozuar nga anëtarë të ICIC sa i përket Statutit të Qeverisjes së këtij forumi. Sekretariati i ICIC paraqiti raportin vjetor të të gjithë veprimtarisë dhe prezantoi disa risi mbi rritjen e bashkëpunimit me një nga partnerët më të ngushtë të këtij forumi UNESCO-n.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përzgjedhur organizatore e ardhshme e ICIC në 2024.

Në mbyllje të ditës së dytë të Sesionit të Hapur, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, mbajti një fjalë përshëndetëse ku tha se zhvillimi i kësaj Konference për herë të parë në Tiranë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor është shumë i rëndësishëm. *“Ne udhëhiqemi nga vizioni i përbashkët për promovimin e ushtrimit të të drejtës për informim dhe transparencës në një mjedis gjithnjë e më shumë të ndërlidhur. Besojmë se këto vlera janë thelbësore për zhvillimin e shoqërive demokratike”* – theksoi ai. Me këtë rast, u paraqit edhe një video-prezantim për Konferencën e ardhshme.



Komiteti Ekzekutiv i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) zhvilloi një mbledhje post konference për të diskutuar dhe shkëmbyer opinione mbi ecurinë e punës së ICIC. Në këtë aktivitet, Komisionerët bënë një përmbledhje të konferencës së zhvilluar dhe ngritën disa pika diskutimi sa i përket edicionit të ardhshëm. Në këtë takim, Komisioneri Dervishi theksoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit dhe ndërveprimit mes institucioneve mbikëqyrëse, në funksion të rritjes së transparencës së autoriteteve publike.



Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit korrik 2023.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit korrik 2023, ka dhënë 1 vendim në zbatim të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit.

Me vendimin nr. 32, datë 12.07.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur rrëzimin e ankesës ndaj Klubit të Futbollit Tirana sh.a. (Autoriteti Publik), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Ankuesi, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") Formularin e Ankesës ku objekt i kërkesës së ankuesit për informacion ishin pyetjet e mëposhtme:

- 1.Sa janë pagesat e përfituara nga anëtarët e bordeve të mbikëqyrjes?
- 2.Cilat janë kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve në bordin e mbikëqyrjes pranë jush?
- 3.Sa është buxheti për bordet e mbikëqyrjes?
- 4.Përse nuk bëhen transparente mbledhjet e bordit mbikëqyrës dhe sa here në muaj mblidhen këto borde në institucionin tuaj?

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, pasi Klubi i Futbollit Tirana sh.a., nuk ka kthyer përgjigje për sa është kërkuar, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI"), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit "Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi...", si dhe gjermës "b" të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: "Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative" ka verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative Klubit të Futbollit Tirana sh.a. Nga verifikimi paraprak, Klubi i Futbollit Tirana sh.a, është shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar

pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik i identifikimit të subjektit L122200271. Referuar ekstraktit të Regjistrin Tregtar për të dhënat e subjektit, rezulton se Klubi i Futbollit Tirana sh.a., është një shoqëri aksionare, me 34% aksione të Bashkisë Tiranë dhe 66% aksione private.

Objekti i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" është garantimi i njohjes së publikut me informacion, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Në kuptim të nenit 2, pika 1 e ligjit të sipërcituar "Autoritet publik":

a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike. Për sa më sipër parashtruar, rezulton se Klub i Futbollit Tirana sh.a., nuk është autoritet publik, në kuptim të LDI.

Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitimit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i LDI, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi rrëzimin e ankesës kundër Klubit të Futbollit Tirana sh.a.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimin në faqen e KDIMDP www.idp.al.



Presidentja e Komitetit Ekzekutiv të ICIC falënderon Zyrën e Komisionerit për kontributin në fushën e të drejtës për informim.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka marrë një letër falënderimi nga Presidentja e Komitetit Ekzekutiv të organizatës, znj. Blanca Lilia Ibarra Cadena, për kontributin dhe pjesëmarrjen aktive në veprimtarinë e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioners-ICIC).

Ky vlerësim vjen si rezultat i angazhimit të Zyrës së Komisionerit në iniciativat bashkëpunuese për shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave të mira me autoritete homologe, shoqërinë civile dhe partnerë, të cilët ndajnë qëllimin dhe objektivat e përbashkëta për promovimin dhe garantimin e të drejtës për informim dhe ritjen e transparencës së autoriteteve publike. Edhe Zyra e Komisionerit, në letrën e saj të falënderimit, thekson se mbetet e përkushtuar për të vijuar bashkëpunimin dhe për të kontribuar në veprimtarinë e ICIC nën leadershipin e Presidentes dhe Sekretariatit të organizatës.



**Promovojmë
Transparencën**

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMDP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDIMDP)